# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| **Nr. 36** | **2000** | **Nëntor** |
|---|---|---|

PËRMBAJTJA


| | | |
|---|---|---|
| Ligj nr.8669 datë 26.10.2000 | Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave | 1745 |
| Dekret nr.2790 datë 14.11.2000 | Për lënie të shtetësisë shqiptare | 1752 |
| Vendim i Kuvendit nr.460, datë 7.11.2000 | Për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për kontrollin e llogarive të Kontrollit të Lartë të Shtetit | 1753 |
| Vendim i KQZ nr.44, datë 7.11.2000 | Për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore tetor 2000 | 1754 |
| Vendim i KM nr.518, datë 21.9.2000 | Për ngushtimin e diferencave të masës së pensioneve të parakohshme | 1759 |
| Vendim i KM nr.584, datë 2.11.2000 | Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ndërtime | 1764 |
| Vendim i KM | Për hapjen e shkollave pasuniversitare pranë Universitetit të | |

| | | |
|---|---|---|
| nr.588, datë 2.11.2000 | Tiranës, Universitetit Politeknik, Universitetit Bujqësor dhe Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve | 1765 |
| Vendim i KM nr.590, datë 2.11.2000 | Për një shtesë në vendimin nr.222, datë 24.5.1997, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Marrëveshjes me Koncesion të formës “BOT”, për hidrocentralin e Kalivaçit” | 1767 |
| Vendim i KM nr.596, datë 13.11.2000 | Për një ndryshim në vendimin nr.194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” | 1768 |
| Vendim i Gj.K nr.81 | Me objekt: Papajtueshmëria me Kushtetutën (me nenet 7, 11/1,3, dhe 41/3) të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999 “Për kthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga ana e personave fizikë e juridikë nga shitja e pasurisë apo transaksioneve të pronësisë“ | 1768 |

**L I G J**
**Nr.8669, datë 26.10.2000**

# PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi i regjistrimit

1. Regjistrimi synon t'u ofrojë Kuvendit, Qeverisë, njësive të qeverisjes vendore, organizatave ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

2. Regjistrimi ofron të dhëna për:

a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë rezidente (banuese);

b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë;

c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave dhe të ndërtesave, që përdoren për qëllime banimi;

ç) kushtet e strehimit të popullsisë.

3. Regjistrimi synon të ofrojë të dhëna të besueshme, të cilat do t'u mundësonin organeve përgjegjëse, ligjore hartimin e listave zgjedhore dhe të pasqyronin të rejat më të fundit në regjistrat civilë.

### Neni 2
### Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 3
### Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtme do të kuptohen kështu:

a) Me "popullsi rezidente" kuptohet popullsia e përbërë nga grupi i individëve, të cilët ditën e regjistrimit ndodhen në territorin e Republikës, si dhe ata që janë larguar për një periudhë prej më pak se një vit.

b) Me "banesë" kuptohen një ose më shumë mjedise, të caktuara për përdorim banimi, që kanë një hyrje të pavarur në rrugë, në kat, në oborr, në taracë dhe që në çastin e regjistrimit është ose janë të banuara ose të përcaktuara për t'u banuar nga një person ose nga një grup personash.

Termat e tjera, që do të përdoren në procesin e regjistrimit, do të përcaktohen në librin e udhëzimeve.

Neni 4
**Detyrimi për t'u përgjigjur**

Të gjithë shtetasit, shqiptarë dhe të huaj, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në çastin e regjistrimit ndodhen brenda territorit të Republikës, janë të detyruar të japin saktësisht të dhënat e kërkuara për regjistrimin, për vete dhe për të afërmit e tyre.

Neni 5
**Institucioni i regjistrimit**

Regjistrimi organizohet dhe zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT) nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe me mbështetjen e komisioneve të regjistrimit, në prefektura dhe të zyrave të regjistrimit në komuna dhe në bashki.

Përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e këtyre organeve përcaktohen në këtë ligj.

Neni 6
**Data e regjistrimit dhe periudha e mbledhjes së të dhënave**

Çasti i regjistrimit është mesnata e 31 marsit 2001. Mbledhja e të dhënave do të kryhet brenda muajit prill 2001.

Neni 7
**Shtrirja e regjistrimit**

1. Regjistrimi mbulon të gjitha zonat, urbane dhe rurale, pra kryhet në çdo qytet dhe fshat të territorit të Republikës.
2. Ai përfshin popullsinë banuese, si dhe të gjitha objektet brenda territorit të Republikës, që përdoren për banim, pavarësisht nëse ato janë pronë e luajtshme ose e paluajtshme.

Neni 8
**Të dhënat e mbledhura**

Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit ndahen në dy kategori:

a) Të dhënat individuale, identifikuese të personave që janë: emri atësia, mbiemri, adresa dhe identifikuesit topografikë.

b) Të dhënat strukturore për karakteristikat e ndërtesave, të banesave, grupeve të personave që jetojnë së bashku, si dhe të individëve, të kërkuara për qëllime vetëm statistikore, në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare.

Neni 9
**Mbrojtja e të dhënave dhe sekreti profesional**

Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit mbrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. INSTAT-i dhe Ministria e Pushtetit Lokal marrin masat e mëposhtme:

a) Personeli, i cili, nëpërmjet angazhimit në regjistrim, përpunimit të listave zgjedhore dhe pasurimit me të dhënat e fundit të regjistrave civilë, ka njohuri për të dhëna vetjake, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional në përputhje me ligjin nr.7687, datë 16.3.1993 "Për statistikën" dhe ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Asnjë autoritet publik nuk mund ta shmangë këtë detyrim, në asnjë rrethanë. Shkelja e këtij detyrimi mbetet e dënueshme edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me programin e regjistrimit.

b) INSTAT-i dhe Ministria e Pushtetit Lokal marrin masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurimit, për të parandaluar çdo hyrje të paautorizuar në vendet dhe instalimet ku ruhen të dhënat e regjistrimit, si dhe për të parandaluar përpunimin e paautorizuar të këtyre të dhënave.

c) Të dhënat e mbledhura për qëllime statistikore, pas kontrolleve teknike për saktësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre, të kryera nga personeli i regjistrimit, bëhen anonime, nëpërmjet fshirjes së të dhënave identifikuese, individuale nga dosjet elektronike.

ç) Të dhënat individuale anonime mund t'i komunikohen një pale të tretë, të autorizuar vetëm për veprimtari që janë në përputhje me qëllimin statistikor të regjistrimit. Marrësi i të dhënave i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional; merr masat e përshtatshme të sigurimit dhe garanton që çdo botim i rezultateve statistikore të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 10
**Rezultatet e regjistrimit**

Rezultatet statistikore të regjistrimit janë një pasuri e përbashkët e të gjithë shoqërisë shqiptare. Ato jepen në kushtet e mëposhtme:

a) INSTAT-i paraqet dhe boton rezultatet e përkohshme dhe ato përfundimtare të regjistrimit mbi baza shkencore dhe profesionale.

b) Rezultatet statistikore, në nivel vendi ose njësie të qeverisjes vendore, janë të publikueshme pa kufizime. Megjithatë, ato duhet të paraqiten në një formë, që përjashton çdo mundësi për identifikimin e individëve të veçantë.

KREU II
PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE MARRËDHËNIET E ORGANEVE TË NGARKUARA PËR TË BËRË REGJISTRIMIN

Neni 11
**Komisioni Qendror i Regjistrimit**

Komisioni Qendror i Regjistrimit përbëhet nga 23 anëtarë, si më poshtë:

| | |
|---|---|
| - Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale | kryetar |
| - Ministri i Financave | anëtar |
| - Ministri i Pushtetit Lokal | anëtar |
| - Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë | anëtar |
| - Ministri i Drejtësisë | anëtar |
| - Ministri i Arsimit dhe Shkencës | anëtar |
| - Ministri i Punëve Publike | anëtar |
| - Ministri i Transportit | anëtar |
| - Ministri i Shëndetësisë | anëtar |
| - Ministri i Rendit Publik | anëtar |
| - Ministri i Mbrojtjes | anëtar |
| - Ministri i Punëve të Jashtme | anëtar |
| - Kryetari i Akademisë së Shkencave | anëtar |
| - Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it | anëtar |
| - Kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme | anëtar |
| - Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore | anëtar |
| - Dekani i Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës | anëtar |
| - Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës | anëtar |
| - Përgjegjësi i Sektorit të Demografisë pranë INSTAT-it | anëtar |
| - Shefi i Departamentit të Statistikave, Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës | anëtar |
| - Tre specialistë nga fushat e ekonomisë, të informatikës dhe demografisë, të zgjedhur nga Komisioni Qendror i Regjistrimit | anëtarë |

Neni 12
**Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Regjistrimit**

Komisioni Qendror i Regjistrimit ka këto përgjegjësi:

a) Harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Regjistrimit.

b) Mbikëqyr përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit dhe udhëzon INSTAT-in për të dhënat statistikore, që priten nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile.

c) Garanton bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve qendrore për regjistrimin dhe mbështetjen e organizatave shkencore.

ç) I propozon Këshillit të Ministrave përbërjen e komisioneve të regjistrimit në prefektura dhe të zyrave të regjistrimit në bashki dhe komuna, si dhe përcakton detyrat e tyre.

Neni 13
**Instituti i Statistikave**

Instituti i Statistikave (INSTAT) ka këto përgjegjësi:

a) Harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësorin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit në baza profesionale dhe shkencore të pavarura.

b) Menaxhon burimet njerëzore dhe financiare të ofruara për regjistrimin dhe u raporton Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe donatorëve ndërkombëtarë përdorimin e këtyre burimeve.

c) Njofton autoritetet dhe organet qeveritare përkatëse për hapat që duhen marrë për regjistrimin, zhvillon fushatën e njoftimit publik dhe raporton në Komisionin Qendror për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit.

ç) Harton termat e referencës dhe udhëzimet e trajnimit që duhen zbatuar nga komisionet e regjistrimit në prefekturë dhe zyrat e regjistrimit, në bashki dhe komuna për përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit të regjistrimit. Drejton punën në terren për realizimin e qëllimeve të këtij ligji dhe merr të gjitha masat e nevojshme për kryerjen, në kohë dhe me korrektësi, të regjistrimit, në bashkëpunim me organet e regjistrimit në njësitë e qeverisjes vendore.

d) Paraqet dhe boton rezultatet paraprake dhe përfundimtare të regjistrimit.

Neni 14
**Komisioni i regjistrimit në prefekturë**

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit, cakton përbërjen e komisioneve të regjistrimit që ngrihen në çdo prefekturë. Ky komision ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Në zbatim të udhëzimeve dhe përcaktimeve të INSTAT-it organizon punën përgatitore për regjistrimin brenda territorit të prefekturës, përzgjedh personelin e regjistrimit, trajnon kontrollorët dhe merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin në kohë dhe me korrektësi të procesit të regjistrimit.

b) U jep asistencë teknike zyrave të regjistrimit, në bashkitë dhe komunat, brenda territorit të prefekturës dhe bën kontrolle periodike në këto zyra për zhvillimin e procesit të regjistrimit.

c) Raporton çdo javë në INSTAT për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit në prefekturë, ndërsa gjatë muajit të regjistrimit raporton çdo ditë.

ç) Në bashkëpunim me INSTAT-in dhe me zyrat e regjistrimit, në bashki dhe komunë, organizon punën për marrjen dhe dërgimin e pyetësorëve të regjistrimit dhe të materialeve shoqëruese në komisionet dhe zyrat e regjistrimit në bashki dhe komunë.

Neni 15
**Zyrat e regjistrimit në bashki dhe komuna**

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit, cakton përbërjen e një zyre regjistrimi, në çdo komunë dhe bashki. Kjo zyrë ka detyrat e mëposhtme:

a) Në zbatim të udhëzimeve dhe të orientimeve të INSTAT-it merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin normal të veprimeve të regjistrimit brenda territorit të bashkisë dhe komunës dhe u jep të dhëna dhe asistencë personelit të regjistrimit në qytete dhe fshatra.

b) Përzgjedh dhe trajnon anketuesit dhe kontrollon kryerjen e detyrave prej tyre.

c) Raporton çdo javë pranë komisionit të regjistrimit në prefekturë për zhvillimin e procesit të regjistrimit brenda territorit të bashkisë ose komunës, ndërsa gjatë muajit të regjistrimit raporton çdo ditë.

ç) Merr masat e duhura për të siguruar pranimin në gjendje të mirë të materialeve të regjistrimit në bashki ose komunë, depozitimin e sigurtë të këtyre materialeve dhe dorëzimin në kohë të tyre në komisionin e regjistrimit të prefekturës.

## KREU III
## PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

### Neni 16
### **Publiciteti**

Qëllimet dhe procedurat e regjistrimit, si dhe detyrimet juridike lidhur me të, do të bëhen publike nëpërmjet mediave dhe një fushate të gjerë njoftimesh të drejtuara nga INSTAT-i. Publiciteti do të fillojë të paktën katër javë para fillimit të regjistrimit.

### Neni 17
### **Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i jep INSTAT-it në kohën e duhur hartat treguese të vendndodhjes së pasurive të paluajtshme.

### Neni 18
### **Personeli i regjistrimit**

Personeli i regjistrimit përbëhet nga:

a) anketuesit, të cilët të pajisur me një shenjë dalluese zyrtare, shkojnë në çdo vendbanim për të intervistuar banorët dhe për të plotësuar me saktësi pyetësorin;

b) kontrollorët, të cilët mbështesin dhe kontrollojnë punën e disa anketuesve;

c) mbikëqyrësit, të cilët mbështesin dhe kontrollojnë punën e disa kontrollorëve;

ç) operatorët, të cilët fusin të dhënat e pyetësorëve në sistemet e kompjuterizuara;

d) personeli drejtues, që organizon dhe drejton përgatitjen, njoftimin, logjistikën dhe administrimin e regjistrimit;

dh) statisticienët, demografët dhe personeli tjetër, të cilët përpunojnë të dhënat, analizojnë përmbledhëset dhe nxjerrin rezultatet statistikore të regjistrimit.

2. INSTAT-i përcakton kriteret për përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e personelit të regjistrimit, të cilët emërohen si më poshtë:

a) Emërimi i anketuesve bëhet nga zyra e regjistrimit në bashki ose komunë.

b) Emërimi i kontrollorëve bëhet nga komisioni i regjistrimit të prefekturave, me propozimin e zyrës së regjistrimit në bashki ose komunë.

c) Emërimi i mbikëqyrësve bëhet nga komisioni i regjistrimit të prefekturave.

ç) Emërimi i operatorëve, i personelit drejtues dhe i ekspertëve shkencorë bëhet nga INSTAT-i.

### Neni 19
### **Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme**

1. Gjatë një periudhe kohore prej 6 javësh para kryerjes së regjistrimit dhe gjatë muajit të mbledhjes së të dhënave të regjistrimit është e ndaluar, për të gjithë individët dhe organizatat, të mbledhin të dhëna brenda territorit të Republikës.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjitha subjektet, të cilët gjatë periudhës së përmendur më lart kanë ndërmend të grumbullojnë të dhëna për individë dhe banesa ose për veprimtari tregtare e private, duhet të kërkojnë një autorizim të veçantë pranë Komisionit Qendror të

Regjistrimit.

KREU IV
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 20
**Kundërvajtjet**

1. Çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenet 4 dhe 9 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 20 000 lekë.
2. Çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenin 19 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 20 000 lekë.

Neni 21

Dënimet me gjobë, për shkelje administrative të parashikuara në nenin 20, jepen nga kryetari i komisionit të regjistrimit në prefekturë. Ankimi kundër këtij dënimi bëhet pranë Komisionit Qendror të Regjistrimit brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Regjistrimit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 10 ditëve.

Procedurat për vënien dhe vjeljen e gjobave rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me parimet e përgjithshme të parashikuara në nenet 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 të këtij ligji.

Neni 23

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të mars - prillit 2001 nuk do të përdoren për hartimin e listave zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2780, datë 7.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**D E K R E T**
**Nr.2790, datë 14.11.2000**

**PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Majlinda Xhelal Kolgjini (Baja)
2. Diana Thoma Stichel (Lula)
3. Blendi Reshat Brahja
4. Hamide Xhemal Burimi (Bega)
5. Valbona Luan Zere (Burimi)
6. Bianca Ektor Zere
7. John Ektor Zere
8. Spiro Lole Çifteli
9. Ermelinda Akile Çifteli (Cani)
10. George Spiro Çifteli
11. Besnik Muharrem Voci
12. Elvisjona Vasillaq Bixho (Holzapfel)
13. Edmond Nikoll Kola
14. Lulzim Qamil Hebibaj
15. Etrit Ndoc Rakaj
16. Fatmir Hamit Shefqata
17. Luam Hamza Henschke (Domi)
18. Raimonda Zoto Popaj (Rjepaj)
19. Leonard Thoma Loshi
20. Alfred Riza Katio
21. Paul Harald Alfred Katio
22. Flynn Gabriel Alfred Katio
23. Sonila Jorgji Katio (Papa)
24. Lejla Idriz Haxhaja (Fani)
25. Jasemina Sami Haxhaja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Rexhep Meidani**

**V E N D I M**
**Nr.460, datë 7.11.2000**

**PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR KONTROLLIN E LLOGARIVE TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", si dhe të neneve 88 e 92 të Rregullores së Kuvendit,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Për të kontrolluar llogaritë e Kontrollit të Lartë të Shtetit caktohen ekspertë kontabël të autorizuar:

1. Hilmi Shtepani
2. Mihal Ziu
3. Fahri Dahri

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**
**Nr.44, datë 07.11.2000**

**PËR SHPALLJEN E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TETOR 2000**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 07.11.2000 pasi shqyrtoi rezultatet e shpallura nga KZQV për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore Tetor 2000, vendimet e gjykatave në lidhje me: rinumërimet si dhe ankimet kundër vendimeve të KZQV-ve si dhe KQZ-së dhe në bazë të vendimeve Nr. 40 datë 07.10.2000 "Për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve të datës 01.10.2000" dhe Nr. 42 datë 21.10.2000 "Për shpalljen e rezultateve të raundit të dytë të datës 15.10.2000" si dhe të pikës 4 të nenit 18 të Ligjit Nr.8609 dt.08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të konsiderojë të përfunduar procesin zgjedhor dhe të shpallë rezultatet e zgjedhjeve, për kryetar bashkie e komune në 63 bashki, 11 njësi bashkiake dhe 304 komuna të vendit si dhe rezultatet e zgjedhjeve për subjektet politike (këshillat e bashkive dhe të komunave) në 385 njësi zgjedhore të vendit, si më poshtë:

1. Numri i bashkive dhe komunave të fituara nga subjektet politike, koalicionet dhe grupimet politike në rang vendi sipas Tabelës Nr.1.

TABELA NR. 1

REZULTATET E SUBJEKTEVE POLITIKE, KOALICIONEVE, GRUPIMEVE POLITIKE PËR KRYETAR BASHKIE / KOMUNE.

Tetor 2000

| Nr. | Subjekti, Koalicioni, Grupimi politik | Shkronja nistore | Numri I Bashkive | % | Numri i Komunave | % | Numri i Bashkive Komunave | % e Përgjith. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Aleanca Demokratike | AD | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 2 | E Djathta e Bashkuar Shqiptare | DBSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | E Djathta e Bashkuar Shqiptare+PR | DBSH+PRSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | I Pavarur | I Pavarur | 1 | 1.32 | 2 | 0.65 | 3 | 0.78 |
| 5 | Lidhja Kombëtare Shqiptare | LKSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Partia Agrare Shqiptare+PSSH | PASH+PSSH | 0 | 0 | 7 | 2.27 | 7 | 1.82 |
| 7 | Partia Agrare Shqiptare+PBDNJ | PASH+PBDNJ | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 8 | Partia Alternativa Liberale Shqiptare | PALSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | Partia Ballit Kombëtar | PBK | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut | PBDNJ | 0 | 0 | 6 | 1.94 | 6 | 1.56 |
| 11 | Partia Bash.Drejtave Njeriut+PSSH | PBDNJ+PSSH | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 12 | Partia Bash.Drejt.Njeriut+PSSH+PSD | PBDNJ+PSSH+PSD | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 13 | Partia Bashkimi Republikan | PBR | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare | PBKSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 15 | Partia Biznesit Shqiptar | PBSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 16 | Partia Demokratike +PLL+PBL+PBKD+PBD | PD+PLL+PBL+PBKD+PBD | 11 | 14.47 | 78 | 25.24 | 89 | 23.11 |
| 17 | Partia Bashkimi Demokrat+PD+PLL+PBL +PBKD | PBD+PD+PLL+PBL +PBKD | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 18 | Partia Demokratike+PR+PLL+PBL+PBKD | PD+PR+PLL+PBL+ PBKD | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 19. | Partia Demokristiane e Shqipërisë | PDK | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 20 | Partia e Mirëqënies Popullore | PMP | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 21 | Partia Emigracionit | PESH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shqiptar | | | | | | | |
| 22 | Partia Forca Albania | PFA | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 23 | Partia Komuniste Shqiptare | PKSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 24 | Partia Komunistëve të Bashkuar | PKBSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 25 | Partia Konservatore | P.KONS. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 26 | Partia Lëvizja e Legalitetit | PLL | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 27 | Partia Lëvizja e Legalitetit +PD+PBL+PBKD+PBD | PLL+PD+PBL+PBKD+PBD | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 28 | Partia Lidhja Fshatare Shqiptare | PLFSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 29 | Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare | PLPSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 30 | Partia Pajtimi Kombëtar Shqiptar | PPK | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 31 | Partia Republikane Shqiptare | PRSH | 0 | 0 | 3 | 0.97 | 3 | 0.78 |
| 32 | Partia Shqiptare Ambientaliste | PSHA | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 33 | Partia Socialdemokrate | PSD | 1 | 1.32 | 4 | 1.29 | 5 | 1.3 |
| 34 | Partia Socialdemokrate+PSSH | PSD+PSSH | 0 | 0 | 4 | 1.29 | 4 | 1.04 |
| 35 | Partia Socialiste +PASH | PSSH+PASH | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 36 | Partia Socialiste +PBDNJ | PSSH+PBDNJ | 2 | 2.63 | 0 | 0 | 2 | 0.52 |
| 37 | Partia Socialiste +PBDNJ+PSD+PASH+PUK | PS+PBDNJ+PSD+PA+PUK | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 38 | Partia Socialiste +PSD | PSSH+PSD | 8 | 10.53 | 16 | 5.18 | 24 | 6.23 |
| 39 | Partia Socialiste +PSD+PASH | PSSH+PSD+PASH | 0 | 0 | 1 | 0.32 | 1 | 0.26 |
| 40 | Partia Socialiste e Shqipërisë | PSSH | 40 | 52.63 | 187 | 60.52 | 227 | 58.96 |
| 41 | Partia Socialkristiane Shqiptare | PSKSH | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 42 | Partia Uniteti Kombëtar | PUK | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | TOTALI | | 63 | | 315 | | 378 | |

Nuk janë shpallur: kryetarët e bashkisë Laç rrethi Kurbin, komunës Kelmend rrethi Malsi e Madhe, komunës Pult rrethi Shkodër sepse janë në proces gjyqësor; komunës Grekan rrethi Elbasan sepse është në balotazh për raundin e dytë; Bashkisë Vau i Dejës rrethi Shkodër, komunës Bujan rrethi Tropojë, në të cilat do të përsëritet votimi për parregullsi në një qendër votimi si dhe në komunën Ballaban rrethi Përmet që është në proces verifikimi.

Bashkangjitur këtij vendimi në Tabelën 1/1 jepet lista e kryetarëve të 64 bashkive, 11 njësive bashkiake dhe 305 komunave si dhe subjektet politike, koalicionet dhe grupimet politike që i kanë mbështetur ato.

Në Tabelat Nr 1/2, 1/3, 1/4 dhe 1/5 jepen numri i votave dhe përqindjet e fituara nga kandidatët në Raundin e Parë dhe në Raundin e Dytë të zgjedhjeve për çdo komunë dhe bashki të vendit.

2. Numri i këshilltarëve në këshillat e bashkive dhe komunave sipas subjekteve politike, koalicioneve dhe grupimeve politike në rang vendi është si në Tabelën Nr. 4

TABELA NR. 2
NUMRI I KËSHILLTARËVE NË KËSHILLAT E BASHKIVE DHE KOMUNAVE SIPAS SUBJEKTEVE POLITIKE, KOALICIONEVE DHE GRUPIMEVE POLITIKE NË RANG VENDI

Tetor 2000

| Nr. | Partia, koalicioni,grupimi politik | Numri i Këshillt.<br><br>Në bashkitë | % | Numri i Këshilltarëve<br>në komunat | % | Numri i përgjithshëm i këshilltarëve | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Aleanca Demokratike | 53 | 3.26 | 185 | 4.14 | 238 | 3.91 |
| 2 | E Djathta e Bashkuar Shqiptare | 39 | 2.40 | 78 | 1.75 | 117 | 1.92 |
| 3 | I Pavarur | 3 | 0.18 | 5 | 0.11 | 8 | 0.13 |
| 4 | Lidhja Kombëtare Shqiptare | 3 | 0.18 | 1 | 0.02 | 4 | 0.07 |
| 5 | Partia Agrare Shqiptare | 9 | 0.55 | 90 | 2.02 | 99 | 1.62 |
| 6 | Partia Agrare Shqiptare +PBDNJ | 0 | 0 | 2 | 0.04 | 2 | 0.03 |
| 7 | Partia Alternativa Liberale Shqiptare | 1 | 0.06 | 1 | 0.02 | 2 | 0.03 |
| 8 | Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut | 35 | 2.15 | 144 | 3.23 | 179 | 2.94 |
| 9 | Partia Bashkimi Republikan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 10 | Partia Bashkimi Kombëtar Demokrat | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |
| 11 | Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |
| 12 | Partia Biznesit Shqiptar | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |
| 13 | Partia Demokratike +PLL+PBL+PBKD+PBD | 504 | 30.96 | 1378 | 30.86 | 1882 | 30.89 |
| 14 | PartiaDemokratike+PR+PLL+PBL +PBKD | 33 | 2.03 | 47 | 1.05 | 80 | 1.31 |
| 15 | Partia Demokristiane e Shqipërisë | 47 | 2.89 | 69 | 1.55 | 116 | 1.90 |
| 16 | Partia e Mirëqënies Popullore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 17 | Partia Emigracionit Shqiptar | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |
| 18 | Partia Forca Albania | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 |
| 19 | Partia Komuniste Shqiptare | 15 | 0.92 | 34 | 0.76 | 49 | 0.80 |
| 20 | Partia Komunistëve të Bashkuar të Sqipërisë | 1 | 0.06 | 11 | 0.25 | 12 | 0.20 |
| 21 | Partia Konservatore | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |
| 22 | Partia Lidhja Fshatare Shqiptare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 23 | Partia Lëvizja e Legalitetit | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |
| 24 | Partia Lëvizja e Legalitetit+PD+PBL+PBKD+PBD | 0 | 0 | 3 | 0.07 | 3 | 0.05 |
| 25 | Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare | 2 | 0.12 | 1 | 0.02 | 3 | 0.05 |
| 26 | Partia Pajtimi Kombëtar Shqiptar | 0 | 0 | 1 | 0.02 | 1 | 0.02 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | Partia Republikane Shqiptare | 42 | 2.58 | 146 | 3.27 | 188 | 3.09 |
| 28 | Partia Shqiptare Ambientaliste | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 29 | Partia Socialdemokrate | 114 | 7.00 | 403 | 9.03 | 517 | 8.49 |
| 30 | Partia Socialiste +PBDNJ | 67 | 4.12 | 17 | 0.38 | 84 | 1.38 |
| 31 | Partia Socialiste +PSD | 10 | 0.61 | 54 | 1.21 | 64 | 1.05 |
| 32 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 645 | 39.62 | 1780 | 39.87 | 2425 | 39.80 |
| 33 | Partia Socialkristiane Shqiptare | 3 | 0.18 | 0 | 0 | 3 | 0.05 |
| 34 | Partia Uniteti Kombëtar | 1 | 0.06 | 3 | 0.07 | 4 | 0.07 |
| | TOTALI | 1627 | | 4459 | | 6086 | |
| | Totali Bashkë me 7 shortet | 1627+1 | | 4459+6 | | 6086+7 | |

Në një bashki dhe në gjashtë komuna, vendi i një këshilltari duhet të përcaktohet me short midis subjekteve politike të më poshtëme:

- Bashkia Selenicë rrethi Vlorë midis DBSH dhe PRSH
- Komuna Tregan rrethi Elbasan midis AD dhe PD+PLL+PBL+PBKD+ PBD
- Komuna Zavalin rrethi Elbasan midis DBSH dhe PSSH
- Komuna Zall Reç rrethi Dibër midis AD dhe PBDNJ
- Komuna Sukë rrethi Përmet midis PRSH dhe PKSH
- Komuna Vëndresh rrethi Skrapar midis PRSH dhe PBDNJ
- Komuna Bërzhitë rrethi Tiranë midis AD dhe PRSH

Bashkangjitur këtij vendimi në Tabelën Nr.2/1 dhe Tabelën Nr.2/2 jepen përkatësisht numri dhe përqindja e këshilltarëve sipas subjekteve politike, koalicioneve dhe grupimeve politike për çdo bashki e komunë të vendit.

2. Rezultatet e subjekteve politike, koalicioneve dhe grupimeve politike për këshillat e bashkive dhe komunave (numri i votave të fituara dhe përqindja) në rang vendi janë si në

TABELA NR.3

REZULTATET E SUBJEKTEVE POLITIKE, KOALICIONEVE DHE GRUPIMEVE POLITIKE PËR KËSHILLAT E BASHKIVE DHE KOMUNAVE NË RANG VENDI

| Nr. | Subjekti politik | Shkronja nistore | Nr. i votave | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 1 | Aleanca Demokratike | AD | 42137 | 3.13 |
| 2 | E Djathta e Bashkuar Shqiptare | DBSH | 28227 | 2.1 |
| 3 | I Pavarur | I Pavarur | 3040 | 0.23 |
| 4 | Lidhja Kombëtare Shqiptare | LKSH | 1597 | 0.12 |
| 5 | Partia Agrare Shqiptare | PASH | 20798 | 1.54 |
| 6 | Partia Agrare Shqiptare+PBDNJ | PASH+PBDNJ | 141 | 0.01 |
| 7 | Partia Alternativa Liberale Shqiptare | PALSH | 1479 | 0.11 |
| 8 | Partia Balli Kombëtar Demokrat | PBKD | 172 | 0.01 |
| 9 | Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare | PBKSH | 187 | 0.01 |
| 10 | Partia Balli Kombëtar | PBK | 85 | 0.006 |
| 11 | Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut | PBDNJ | 30757 | 2.28 |
| 12 | Partia Bashkimi Republikan | PBR | 787 | 0.06 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13 | Partia Biznesit Shqiptar | PBSH | 160 | 0.01 |
| 14 | Partia Demokratike +PLL+PBL+PBKD+PBD | PD+PLL+PBL+PBKD+PBD | 417312 | 30.98 |
| 15 | Partia Demokratike+PR+PLL+PBL+PBKD | PD+PR+PLL+PBL+PBKD | 34740 | 2.58 |
| 16 | Partia Demokristiane e Shqipërisë | PDK | 31447 | 2.34 |
| 17 | Partia e Mirëqënies Popullore | PMP | 138 | 0.01 |
| 18 | Partia Emigracionit Shqiptar | PESH | 234 | 0.02 |
| 19 | Partia Forca Albania | PFA | 142 | 0.01 |
| 20 | Partia Komuniste Shqiptare | PKSH | 11508 | 0.85 |
| 21 | Partia Komunistëve të Bashkuar të Sqipërisë | PKBSH | 4499 | 0.33 |
| 22 | Partia Konservatore | P.KONS. | 874 | 0.07 |
| 23 | Partia Lë vizja e Legalitetitt | PLL | 68 | 0.01 |
| 24 | Partia Lidhja e Legalitetit +PD+PBL+PBKD+PBD | PLL+PD+PBL+PBKD+PBD | 264 | 0.02 |
| 25 | Partia Lidhja Fshatare Shqiptare | PLFSH | 674 | 0.05 |
| 26 | Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare | PLPSH | 859 | 0.06 |
| 27 | Partia Pajtimi Kombëtar Shqiptar | PPK | 430 | 0.03 |
| 28 | Partia Republikane Shqiptare | PRSH | 36591 | 2.72 |
| 29 | Partia Shqiptare Ambientaliste | PSHA | 386 | 0.03 |
| 30 | Partia Socialdemokrate | PSD | 95736 | 7.11 |
| 31 | Partia Socialiste +PBDNJ | PSSH+PBDNJ | 39164 | 2.91 |
| 32 | Partia Socialiste +PSD | PSSH+PSD | 8381 | 0.62 |
| 33 | Partia Socialiste e Shqipërisë | PSSH | 532261 | 39.51 |
| 34 | Partia Socialkristiane Shqiptare | PSKSH | 1140 | 0.08 |
| 35 | Partia Uniteti Kombëtar | PUK | 917 | 0.07 |

Bashkangjitur këtij vendimi në Tabelën Nr.3/1 dhe Tabelen Nr.3/2, jepen numri i votave dhe përqindjet e fituara nga subjektet politike, koalicionet dhe grupimet politike për këshillat në çdo bashki dhe komunë të vendit.

2. Numri i votuesve, numri i fletëve të votimit të dëmtuara, numri votave të pavlefshme si dhe numri i votave të vlefshme për Raundin e parë dhe të dytë të zgjedhjeve, në rang vendi jepen në Tabelën Nr. 4.

## TABELA NR. 4
## NUMRI I ZGJEDHËSVE, NUMRI I VOTUESVE, FLETËT E VOTIMIT TË DËMTUARA, VOTAT E PAVLEFSHME DHE TË VLEFSHME NË RANG VENDI

Tetor 2000

Raundi i parë

| | Nr. i Zgjedhësve sipas Listës A | Nr i Votuesve | % E votuesve | Fletë votimi Të dëmtuara | % | Vota të Pavlefshme | % | Vota të vlefshme | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Për Kryetar | 2329014 | 1443705 | 61.99 | 17863 | 1.24 | 97216 | 6.73 | 1346489 | 93 |
| Për Këshilltar | 2329014 | 1448411 | 62.99 | 48889 | 3.38 | 97883 | 6.76 | 1350528 | 93.2 |

Raundi i dytë

| | Nr. i Zgjedhësve sipas Listës A | Nr i Votuesve | % E votuesve | Fletë votimi të dëmtuara | % | Vota të Pavlefshme | % | Vota të vlefshme | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Për Kryetar | 969148 | 459381 | 47.4 | 3366 | 0.73 | 12499 | 2.72 | 446882 | 97.3 |

Bashkangjitur këtij vendimi në Tabelën Nr. 4/1 dhe në Tabelën 4/2 jepet numri i zgjedhësve sipas Listës A, numri i fletëvotimeve të dëmtuara, numri i votave të vlefshme dhe të pavlefshme për çdo bashki e komunë të vendit, për Raundin e Parë dhe të Dytë.

2. Në Raundin e Parë të zgjedhjeve për parregullsi në procesin e votimit u përsëritën zgjedhjet në: komunën Ksamil rrethi Sarandë për kryetarin e komunës, në komunën Velipojë rrethi Shkodër në qendrën e votimit Nr. 6 për këshillin dhe kryetarin e komunës, në komunën Paskuqan rrethi i Tiranës për këshillin dhe kryetarin e komunës, në komunën Kodovjat rrethi Gramsh për këshillin.

3. Në Raundin e Dytë të zgjedhjeve për parregullsi në procesin e votimit u përsëritën zgjedhjet në komunën Krahëz rrethi Tepelenë në qendrën e votimit Nr. 5, në komunën Zall Bastar rrethi Tiranë në qendrën e votimit Nr. 3, në komunën Pult rrethi Shkodër në qendrat e votimit Nr.8, 10, në komunën Malzi të rrethit Kukës në qendrën e votimit Nr. 3.

ZV/KRYETARI
Mimoza ARBI

KRYETARI
Prof. Dr. Fotaq NANO

ANËTARËT

Klement ZGURI
Pandeli VARFI
Shahin BISTRI

Gaspër KOKAJ
Maksim SHIMANI

**V E N D I M**
**Nr.518, datë 21.9.2000**

**PËR NGUSHTIMIN E DIFERENCAVE TË MASËS SË PENSIONEVE TË PARAKOHSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e parakohshme të pleqërisë, të caktuara deri në datën 30.9.1993, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", me shumë pensioni në këtë datë nga 1238 deri në 1967 lekë në muaj, të cilat vazhdojnë të paguhen edhe pas datës

1.9.2000, të shtohen me shuma fikse nga 54 lekë deri në 2323 lekë në muaj.

Këtë rritje pensionet e parakohshme, të caktuara deri në datën 30.9.1993, e përfitojnë edhe kur janë rillogaritur si pensione të plota nga 1.10.1993, deri në 31.8.2000, përfshi edhe këtë datë.

2. Shuma individuale e pensionit, e rillogaritur sipas pikës 1 të këtij vendimi, përcaktohet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogaritura në shumën 30 milionë lekë në muaj, të përballohen nga tejkalimi i të ardhurave në fondin e sigurimeve shoqërore, për periudhën janar- korrik të vitit 2000. Në buxhetin e vitit 2000 për Sigurimet Shoqërore, të ardhurat dhe shpenzimet shtohen në 90 milionë lekë.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi.

5. Efektet e këtij vendimi shtrihen nga data 1.10.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

## TABELA SHOQERUESE E VENDIMIT

| Masa e pensionit deri ne date 30.09.1993 ne leke | Shtesa ne leke kundrejt pensionit aktual ne vitin 2000 |
|---|---|
| (1) | (2) |
| 1.238 | 54 |
| 1.239 | 54 |
| 1.240 | 54 |
| 1.241 | 54 |
| 1.242 | 66 |
| 1.243 | 66 |
| 1.244 | 66 |
| 1.245 | 78 |
| 1.246 | 78 |
| 1.247 | 90 |
| 1.248 | 90 |
| 1.249 | 90 |
| 1.250 | 101 |
| 1.251 | 102 |
| 1.252 | 102 |
| 1.253 | 113 |
| 1.254 | 113 |
| 1.255 | 113 |
| 1.256 | 125 |
| 1.257 | 125 |
| 1.258 | 125 |
| 1.259 | 137 |
| 1.260 | 137 |
| 1.261 | 149 |
| 1.262 | 149 |
| 1.263 | 149 |
| 1.264 | 160 |
| 1.265 | 160 |
| 1.266 | 160 |
| 1.267 | 172 |
| 1.268 | 172 |
| 1.269 | 172 |
| 1.270 | 184 |
| 1.271 | 184 |
| 1.272 | 184 |
| 1.273 | 196 |
| 1.274 | 196 |
| 1.275 | 207 |
| 1.276 | 207 |
| 1.277 | 207 |
| 1.278 | 219 |
| 1.279 | 219 |
| 1.280 | 219 |
| 1.281 | 231 |
| 1,282 | 231 |
| 1,283 | 231 |
| 1,284 | 243 |
| 1,285 | 243 |
| 1,286 | 243 |
| 1,287 | 254 |
| 1,288 | 254 |
| 1,289 | 266 |
| 1,290 | 266 |
| 1,291 | 266 |
| 1,292 | 278 |
| 1,293 | 278 |
| 1,294 | 278 |
| 1,295 | 290 |
| 1,296 | 290 |
| 1,297 | 290 |
| 1,298 | 302 |
| 1,299 | 302 |
| 1,300 | 302 |
| 1,301 | 313 |
| 1,302 | 313 |
| 1,303 | 325 |
| 1,304 | 325 |
| 1,305 | 325 |
| 1,306 | 337 |
| 1,307 | 337 |
| 1,308 | 338 |
| 1,309 | 349 |
| 1,310 | 349 |
| 1,311 | 350 |
| 1,312 | 360 |
| 1,313 | 360 |
| 1,314 | 361 |
| 1,315 | 372 |
| 1,316 | 372 |
| 1,317 | 384 |
| 1,318 | 384 |
| 1,319 | 385 |
| 1,320 | 396 |
| 1,321 | 396 |
| 1,322 | 397 |
| 1,323 | 407 |
| 1,324 | 407 |
| 1,325 | 408 |
| 1,326 | 419 |
| 1,327 | 419 |
| 1,328 | 420 |
| 1,329 | 431 |
| 1,330 | 431 |
| 1,331 | 443 |
| 1,332 | 443 |
| 1,333 | 444 |
| 1,334 | 455 |
| 1,335 | 455 |
| 1,336 | 456 |
| 1,337 | 466 |
| 1,338 | 466 |
| 1,339 | 467 |
| 1,340 | 478 |
| 1,341 | 478 |
| 1,342 | 479 |
| 1,343 | 490 |
| 1,344 | 490 |
| 1,345 | 491 |
| 1,346 | 502 |
| 1,347 | 502 |
| 1,348 | 513 |
| 1,349 | 513 |
| 1,350 | 514 |
| 1,351 | 525 |
| 1,352 | 525 |
| 1,353 | 526 |
| 1,354 | 537 |
| 1,355 | 537 |
| 1,356 | 538 |
| 1,357 | 549 |
| 1,358 | 549 |
| 1,359 | 550 |
| 1,360 | 560 |
| 1,361 | 560 |
| 1,362 | 572 |
| 1,363 | 572 |
| 1,364 | 573 |
| 1,365 | 584 |
| 1,366 | 584 |
| 1,367 | 585 |
| 1,368 | 596 |
| 1,369 | 596 |
| 1,370 | 597 |
| 1,371 | 608 |
| 1,372 | 608 |
| 1,373 | 609 |
| 1,374 | 619 |
| 1,375 | 619 |
| 1,376 | 631 |
| 1,377 | 631 |
| 1,378 | 632 |
| 1,379 | 643 |
| 1,380 | 643 |
| 1,381 | 644 |
| 1,382 | 655 |
| 1,383 | 655 |
| 1,384 | 656 |
| 1,385 | 666 |
| 1,386 | 666 |
| 1,387 | 667 |
| 1,388 | 678 |
| 1,389 | 678 |
| 1,390 | 690 |
| 1,391 | 690 |
| 1,392 | 691 |
| 1,393 | 702 |
| 1,394 | 703 |
| 1,395 | 703 |
| 1,396 | 713 |
| 1,397 | 714 |
| 1,398 | 714 |
| 1,399 | 725 |
| 1,400 | 726 |
| 1,401 | 726 |
| 1,402 | 737 |
| 1,403 | 738 |
| 1,404 | 749 |
| 1,405 | 750 |
| 1,406 | 750 |
| 1,407 | 761 |

## TABELA SHOQERUESE E VENDIMIT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1,408 | 762 | 1,475 | 1,044 | 1,542 | 1,326 |
| 1,409 | 762 | 1,476 | 1,044 | 1,543 | 1,327 |
| 1,410 | 772 | 1,477 | 1,055 | 1,544 | 1,328 |
| 1,411 | 773 | 1,478 | 1,056 | 1,545 | 1,337 |
| 1,412 | 773 | 1,479 | 1,056 | 1,546 | 1,338 |
| 1,413 | 784 | 1,480 | 1,067 | 1,547 | 1,349 |
| 1,414 | 785 | 1,481 | 1,068 | 1,548 | 1,350 |
| 1,415 | 785 | 1,482 | 1,068 | 1,549 | 1,351 |
| 1,416 | 796 | 1,483 | 1,078 | 1,550 | 1,361 |
| 1,417 | 797 | 1,484 | 1,079 | 1,551 | 1,362 |
| 1,418 | 808 | 1,485 | 1,079 | 1,552 | 1,363 |
| 1,419 | 809 | 1,486 | 1,090 | 1,553 | 1,373 |
| 1,420 | 809 | 1,487 | 1,091 | 1,554 | 1,374 |
| 1,421 | 819 | 1,488 | 1,102 | 1,555 | 1,375 |
| 1,422 | 820 | 1,489 | 1,103 | 1,556 | 1,384 |
| 1,423 | 820 | 1,490 | 1,103 | 1,557 | 1,385 |
| 1,424 | 831 | 1,491 | 1,114 | 1,558 | 1,386 |
| 1,425 | 832 | 1,492 | 1,115 | 1,559 | 1,396 |
| 1,426 | 832 | 1,493 | 1,115 | 1,560 | 1,397 |
| 1,427 | 843 | 1,494 | 1,125 | 1,561 | 1,408 |
| 1,428 | 844 | 1,495 | 1,126 | 1,562 | 1,409 |
| 1,429 | 844 | 1,496 | 1,127 | 1,563 | 1,410 |
| 1,430 | 855 | 1,497 | 1,137 | 1,564 | 1,420 |
| 1,431 | 856 | 1,498 | 1,138 | 1,565 | 1,421 |
| 1,432 | 866 | 1,499 | 1,139 | 1,566 | 1,422 |
| 1,433 | 867 | 1,500 | 1,149 | 1,567 | 1,431 |
| 1,434 | 867 | 1,501 | 1,150 | 1,568 | 1,432 |
| 1,435 | 878 | 1,502 | 1,161 | 1,569 | 1,433 |
| 1,436 | 879 | 1,503 | 1,162 | 1,570 | 1,443 |
| 1,437 | 879 | 1,504 | 1,163 | 1,571 | 1,444 |
| 1,438 | 890 | 1,505 | 1,172 | 1,572 | 1,445 |
| 1,439 | 891 | 1,506 | 1,173 | 1,573 | 1,455 |
| 1,440 | 891 | 1,507 | 1,174 | 1,574 | 1,456 |
| 1,441 | 902 | 1,508 | 1,184 | 1,575 | 1,467 |
| 1,442 | 903 | 1,509 | 1,185 | 1,576 | 1,468 |
| 1,443 | 903 | 1,510 | 1,186 | 1,577 | 1,469 |
| 1,444 | 914 | 1,511 | 1,196 | 1,578 | 1,479 |
| 1,445 | 915 | 1,512 | 1,197 | 1,579 | 1,480 |
| 1,446 | 925 | 1,513 | 1,198 | 1,580 | 1,481 |
| 1,447 | 926 | 1,514 | 1,208 | 1,581 | 1,490 |
| 1,448 | 926 | 1,515 | 1,209 | 1,582 | 1,491 |
| 1,449 | 937 | 1,516 | 1,220 | 1,583 | 1,492 |
| 1,450 | 938 | 1,517 | 1,221 | 1,584 | 1,502 |
| 1,451 | 938 | 1,518 | 1,222 | 1,585 | 1,503 |
| 1,452 | 949 | 1,519 | 1,231 | 1,586 | 1,504 |
| 1,453 | 950 | 1,520 | 1,232 | 1,587 | 1,514 |
| 1,454 | 950 | 1,521 | 1,233 | 1,588 | 1,515 |
| 1,455 | 961 | 1,522 | 1,243 | 1,589 | 1,526 |
| 1,456 | 962 | 1,523 | 1,244 | 1,590 | 1,527 |
| 1,457 | 962 | 1,524 | 1,245 | 1,591 | 1,528 |
| 1,458 | 972 | 1,525 | 1,255 | 1,592 | 1,537 |
| 1,459 | 973 | 1,526 | 1,256 | 1,593 | 1,538 |
| 1,460 | 984 | 1,527 | 1,257 | 1,594 | 1,539 |
| 1,461 | 985 | 1,528 | 1,267 | 1,595 | 1,549 |
| 1,462 | 985 | 1,529 | 1,268 | 1,596 | 1,550 |
| 1,463 | 996 | 1,530 | 1,269 | 1,597 | 1,551 |
| 1,464 | 997 | 1,531 | 1,278 | 1,598 | 1,561 |
| 1,465 | 997 | 1,532 | 1,279 | 1,599 | 1,562 |
| 1,466 | 1,008 | 1,533 | 1,290 | 1,600 | 1,563 |
| 1,467 | 1,009 | 1,534 | 1,291 | 1,601 | 1,573 |
| 1,468 | 1,009 | 1,535 | 1,292 | 1,602 | 1,574 |
| 1,469 | 1,019 | 1,536 | 1,302 | 1,603 | 1,584 |
| 1,470 | 1,020 | 1,537 | 1,303 | 1,604 | 1,585 |
| 1,471 | 1,020 | 1,538 | 1,304 | 1,605 | 1,586 |
| 1,472 | 1,031 | 1,539 | 1,314 | 1,606 | 1,596 |
| 1,473 | 1,032 | 1,540 | 1,315 | 1,607 | 1,597 |
| 1,474 | 1,043 | 1,541 | 1,316 | 1,608 | 1,598 |

## TABELA SHOQERUESE E VENDIMIT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.609 | 1,608 | 1,676 | 1,798 | 1,743 | 1,919 |
| 1.610 | 1,609 | 1,677 | 1,799 | 1,744 | 1,923 |
| 1.611 | 1,610 | 1,678 | 1,800 | 1,745 | 1,924 |
| 1.612 | 1,620 | 1,679 | 1,803 | 1,746 | 1,928 |
| 1.613 | 1,621 | 1,680 | 1,804 | 1,747 | 1,929 |
| 1.614 | 1,622 | 1,681 | 1,805 | 1,748 | 1,930 |
| 1.615 | 1,632 | 1,682 | 1,808 | 1,749 | 1,933 |
| 1.616 | 1,633 | 1,683 | 1,809 | 1,750 | 1,934 |
| 1.617 | 1,643 | 1,684 | 1,810 | 1,751 | 1,935 |
| 1.618 | 1,644 | 1,685 | 1,813 | 1,752 | 1,938 |
| 1.619 | 1,645 | 1,686 | 1,814 | 1,753 | 1,939 |
| 1.620 | 1,655 | 1,687 | 1,819 | 1,754 | 1,940 |
| 1.621 | 1,656 | 1,688 | 1,820 | 1,755 | 1,943 |
| 1.622 | 1,657 | 1,689 | 1,821 | 1,756 | 1,944 |
| 1.623 | 1,667 | 1,690 | 1,824 | 1,757 | 1,945 |
| 1.624 | 1,668 | 1,691 | 1,825 | 1,758 | 1,949 |
| 1.625 | 1,669 | 1,692 | 1,826 | 1,759 | 1,950 |
| 1.626 | 1,679 | 1,693 | 1,829 | 1,760 | 1,954 |
| 1.627 | 1,680 | 1,694 | 1,830 | 1,761 | 1,955 |
| 1.628 | 1,681 | 1,695 | 1,831 | 1,762 | 1,956 |
| 1.629 | 1,690 | 1,696 | 1,834 | 1,763 | 1,959 |
| 1.630 | 1,691 | 1,697 | 1,835 | 1,764 | 1,960 |
| 1.631 | 1,702 | 1,698 | 1,836 | 1,765 | 1,961 |
| 1.632 | 1,703 | 1,699 | 1,839 | 1,766 | 1,964 |
| 1.633 | 1,704 | 1,700 | 1,840 | 1,767 | 1,965 |
| 1.634 | 1,714 | 1,701 | 1,845 | 1,768 | 1,966 |
| 1.635 | 1,715 | 1,702 | 1,846 | 1,769 | 1,969 |
| 1.636 | 1,716 | 1,703 | 1,847 | 1,770 | 1,970 |
| 1.637 | 1,726 | 1,704 | 1,850 | 1,771 | 1,971 |
| 1.638 | 1,727 | 1,705 | 1,851 | 1,772 | 1,975 |
| 1.639 | 1,728 | 1,706 | 1,852 | 1,773 | 1,976 |
| 1.640 | 1,730 | 1,707 | 1,855 | 1,774 | 1,980 |
| 1.641 | 1,731 | 1,708 | 1,856 | 1,775 | 1,981 |
| 1.642 | 1,732 | 1,709 | 1,857 | 1,776 | 1,982 |
| 1.643 | 1,735 | 1,710 | 1,860 | 1,777 | 1,985 |
| 1.644 | 1,736 | 1,711 | 1,861 | 1,778 | 1,986 |
| 1.645 | 1,741 | 1,712 | 1,862 | 1,779 | 1,987 |
| 1.646 | 1,742 | 1,713 | 1,865 | 1,780 | 1,990 |
| 1.647 | 1,743 | 1,714 | 1,866 | 1,781 | 1,991 |
| 1.648 | 1,746 | 1,715 | 1,867 | 1,782 | 1,992 |
| 1.649 | 1,747 | 1,716 | 1,871 | 1,783 | 1,995 |
| 1.650 | 1,748 | 1,717 | 1,872 | 1,784 | 1,996 |
| 1.651 | 1,751 | 1,718 | 1,876 | 1,785 | 1,997 |
| 1.652 | 1,752 | 1,719 | 1,877 | 1,786 | 2,001 |
| 1.653 | 1,753 | 1,720 | 1,878 | 1,787 | 2,002 |
| 1.654 | 1,756 | 1,721 | 1,881 | 1,788 | 2,006 |
| 1.655 | 1,757 | 1,722 | 1,882 | 1,789 | 2,007 |
| 1.656 | 1,758 | 1,723 | 1,883 | 1,790 | 2,008 |
| 1.657 | 1,761 | 1,724 | 1,886 | 1,791 | 2,011 |
| 1.658 | 1,762 | 1,725 | 1,887 | 1,792 | 2,012 |
| 1.659 | 1,767 | 1,726 | 1,888 | 1,793 | 2,013 |
| 1.660 | 1,768 | 1,727 | 1,891 | 1,794 | 2,016 |
| 1.661 | 1,769 | 1,728 | 1,892 | 1,795 | 2,017 |
| 1.662 | 1,772 | 1,729 | 1,893 | 1,796 | 2,018 |
| 1.663 | 1,773 | 1,730 | 1,897 | 1,797 | 2,021 |
| 1.664 | 1,774 | 1,731 | 1,898 | 1,798 | 2,022 |
| 1.665 | 1,777 | 1,732 | 1,902 | 1,799 | 2,023 |
| 1.666 | 1,778 | 1,733 | 1,903 | 1,800 | 2,027 |
| 1.667 | 1,779 | 1,734 | 1,904 | 1,801 | 2,028 |
| 1.668 | 1,782 | 1,735 | 1,907 | 1,802 | 2,032 |
| 1.669 | 1,783 | 1,736 | 1,908 | 1,803 | 2,033 |
| 1.670 | 1,784 | 1,737 | 1,909 | 1,804 | 2,034 |
| 1.671 | 1,787 | 1,738 | 1,912 | 1,805 | 2,037 |
| 1.672 | 1,788 | 1,739 | 1,913 | 1,806 | 2,038 |
| 1.673 | 1,793 | 1,740 | 1,914 | 1,807 | 2,039 |
| 1.674 | 1,794 | 1,741 | 1,917 | 1,808 | 2,042 |
| 1.675 | 1,795 | 1,742 | 1,918 | 1,809 | 2,043 |

TABELA SHOQERUESE E VENDIMIT

| | |
|---|---|
| 1,810 | 2,044 |
| 1,811 | 2,047 |
| 1,812 | 2,048 |
| 1,813 | 2,049 |
| 1,814 | 2,053 |
| 1,815 | 2,054 |
| 1,816 | 2,058 |
| 1,817 | 2,059 |
| 1,818 | 2,060 |
| 1,819 | 2,063 |
| 1,820 | 2,064 |
| 1,821 | 2,065 |
| 1,822 | 2,068 |
| 1,823 | 2,069 |
| 1,824 | 2,070 |
| 1,825 | 2,073 |
| 1,826 | 2,074 |
| 1,827 | 2,075 |
| 1,828 | 2,079 |
| 1,829 | 2,080 |
| 1,830 | 2,084 |
| 1,831 | 2,085 |
| 1,832 | 2,086 |
| 1,833 | 2,089 |
| 1,834 | 2,090 |
| 1,835 | 2,091 |
| 1,836 | 2,094 |
| 1,837 | 2,095 |
| 1,838 | 2,096 |
| 1,839 | 2,099 |
| 1,840 | 2,100 |
| 1,841 | 2,101 |
| 1,842 | 2,105 |
| 1,843 | 2,106 |
| 1,844 | 2,110 |
| 1,845 | 2,111 |
| 1,846 | 2,112 |
| 1,847 | 2,115 |
| 1,848 | 2,116 |
| 1,849 | 2,117 |
| 1,850 | 2,120 |
| 1,851 | 2,121 |
| 1,852 | 2,122 |
| 1,853 | 2,125 |
| 1,854 | 2,126 |
| 1,855 | 2,127 |
| 1,856 | 2,131 |
| 1,857 | 2,132 |
| 1,858 | 2,136 |
| 1,859 | 2,137 |
| 1,860 | 2,138 |
| 1,861 | 2,141 |
| 1,862 | 2,142 |
| 1,863 | 2,143 |
| 1,864 | 2,147 |
| 1,865 | 2,148 |
| 1,866 | 2,149 |
| 1,867 | 2,151 |
| 1,868 | 2,152 |
| 1,869 | 2,153 |
| 1,870 | 2,157 |
| 1,871 | 2,158 |
| 1,872 | 2,162 |
| 1,873 | 2,163 |
| 1,874 | 2,164 |
| 1,875 | 2,167 |
| 1,876 | 2,168 |
| 1,877 | 2,169 |
| 1,878 | 2,172 |
| 1,879 | 2,173 |
| 1,880 | 2,174 |
| 1,881 | 2,177 |
| 1,882 | 2,178 |
| 1,883 | 2,179 |
| 1,884 | 2,183 |
| 1,885 | 2,184 |
| 1,886 | 2,185 |
| 1,887 | 2,188 |
| 1,888 | 2,189 |
| 1,889 | 2,193 |
| 1,890 | 2,194 |
| 1,891 | 2,195 |
| 1,892 | 2,198 |
| 1,893 | 2,199 |
| 1,894 | 2,200 |
| 1,895 | 2,203 |
| 1,896 | 2,204 |
| 1,897 | 2,205 |
| 1,898 | 2,209 |
| 1,899 | 2,210 |
| 1,900 | 2,211 |
| 1,901 | 2,214 |
| 1,902 | 2,215 |
| 1,903 | 2,219 |
| 1,904 | 2,220 |
| 1,905 | 2,221 |
| 1,906 | 2,224 |
| 1,907 | 2,225 |
| 1,908 | 2,226 |
| 1,909 | 2,229 |
| 1,910 | 2,230 |
| 1,911 | 2,231 |
| 1,912 | 2,235 |
| 1,913 | 2,236 |
| 1,914 | 2,237 |
| 1,915 | 2,240 |
| 1,916 | 2,241 |
| 1,917 | 2,245 |
| 1,918 | 2,246 |
| 1,919 | 2,247 |
| 1,920 | 2,250 |
| 1,921 | 2,251 |
| 1,922 | 2,252 |
| 1,923 | 2,255 |
| 1,924 | 2,256 |
| 1,925 | 2,257 |
| 1,926 | 2,261 |
| 1,927 | 2,262 |
| 1,928 | 2,263 |
| 1,929 | 2,266 |
| 1,930 | 2,267 |
| 1,931 | 2,271 |
| 1,932 | 2,272 |
| 1,933 | 2,273 |
| 1,934 | 2,276 |
| 1,935 | 2,277 |
| 1,936 | 2,278 |
| 1,937 | 2,281 |
| 1,938 | 2,282 |
| 1,939 | 2,283 |
| 1,940 | 2,287 |
| 1,941 | 2,288 |
| 1,942 | 2,289 |
| 1,943 | 2,292 |
| 1,944 | 2,293 |
| 1,945 | 2,297 |
| 1,946 | 2,298 |
| 1,947 | 2,299 |
| 1,948 | 2,302 |
| 1,949 | 2,303 |
| 1,950 | 2,304 |
| 1,951 | 2,307 |
| 1,952 | 2,308 |
| 1,953 | 2,309 |
| 1,954 | 2,313 |
| 1,955 | 2,314 |
| 1,956 | 2,315 |
| 1,957 | 2,318 |
| 1,958 | 2,319 |
| 1,959 | 2,323 |
| 1,960 | 2,323 |
| 1,961 | 2,323 |
| 1,962 | 2,323 |
| 1,963 | 2,323 |
| 1,964 | 2,323 |
| 1,965 | 2,323 |
| 1,966 | 2,323 |
| 1,967 | 2,323 |

**V E N D I M**
**Nr.584, datë 2.11.2000**

**PËR KURSIMIN E ENERGJISË DHE RUAJTJEN E NGROHTËSISË NË NDËRTIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 4 dhe 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të gjitha objektet, që do të ndërtohen për banim, si dhe ndërtimet publike a private detyrohen të vendosin në ndërtesa instalimet e ngrohjes qendrore vendore ose individuale.

2. Burimet energjetike, që do të përdoren për ngrohje, të jenë me lëndë djegëse organike, të ngurta, të lëngta dhe të gazta. Në asnjë rast sistemet e ngrohjes nuk duhet të parashikojnë përdorimin e energjisë elektrike.

3. Të gjithë personat, fizikë ose juridikë, që hartojnë projekte për ndërtimin e objekteve, publike dhe private, do të përfshijnë në to edhe instalimet e ngrohjes, sipas pikës 2, duke patur parasysh normativat e Komunitetit Europian të ngrohjes së banesave dhe të ndërtimeve publike e private.

4. KRRT-të e bashkive të miratojnë lejet e ndërtimit vetëm pasi të jenë përfshirë në projektet e paraqitura edhe projektet për instalimet e ngrohjes, sipas përcaktimeve në pikat e mësipërme.

5. Kryerja e procedurave të kolaudimit të objekteve dhe marrja në dorëzim e tyre të bëhet pas provave me ngarkesë të sistemit të ngrohjes.

6. AKE-ja të hartojë rregulloren teknike për vënien në punë të impiantit të ngrohjes qendrore.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Financave, KRRT-të e bashkive dhe AKE-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr.588, datë 2.11.2000**

**PËR HAPJEN E SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, UNIVERSITETIT POLITEKNIK, UNIVERSITETIT BUJQËSOR DHE AKADEMISË SË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të shtatë, të nenit 13 dhe të neneve 24, 37 dhe 38, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e shkollave pasuniversitare (SHPU) për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002 pranë shkollave të larta universitare si më poshtë:

Pranë fakulteteve të Universitetit të Tiranës, në këto drejtime:

a) Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë:

- SHPU në gjuhë shqipe
- SHPU në letërsi
- SHPU në histori, me drejtimet: histori, arkeologji, etnologji
- SHPU në gjeografi

b) Fakulteti i Shkencave të Natyrës:

- SHPU në biologji, me drejtimet: botanikë, zoologji-ekologji, biologji qelizore molekulare, mikrobiologji-biotekologji, gjenetikë e popullateve, mbrojtje mjedisi.
- SHPU në kimi, me drejtimet: analizë kimike, elektrokimi, përpunim kimiko-teknologjik, inxhinieri ushqimore.
- SHPU në fizikë, me drejtimet: fizikë e materies së kondensuar, biofizikë.
- SHPU në matematikë, me drejtimet: kërkime operacionale, topologji dhe analizë funksionale, analizë numerike, propabilitet e statistikë dhe zbatime të tyre, alegjebër.
- SHPU në informatikë
- SHPU në farmaci (përgatitja dhe kontrolli i cilësisë së barnave).

c) Fakulteti i Ekonomisë:

- SHPU në ekonomiks
- SHPU në financë kontabilitet
- SHPU në marketing

ç) Fakulteti i Drejtësisë

- SHPU në të drejtën civile
- SHPU në shkenca penale
- SHPU në të drejtën publike

d) Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:

- SHPU në gjuhësi, me drejtimet: gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë italiane, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë ballkanike.
- SHPU në letërsi, me drejtimet: letërsi angleze, letërsi frënge, letërsi italiane, letërsi gjermane, letërsi ruse-ballkanike

dh) Fakulteti i Shkencave Sociale:

- SHPU në filozofi-sociologji, me drejtimet: filozofi, sociologji
- SHPU në psikologji-pedagogji, me drejtimet: mësimdhënie, këshillim psikologjik
- SHPU në punë sociale

e) Fakulteti i Mjekësisë:

- SHPU në sëmundje të brendshme
- SHPU në neurologji-neurokirurgji-psikiatri
- SHPU në anatomi patologjike dhe mjekësi ligjore
- SHPU në ORL dhe okulistikë
- SHPU në kirurgji
- SHPU në obstetrikë-gjinekologji
- SHPU në pediatri
- SHPU në shëndet publik
- SHPU në infektiv-dermatologji
- SHPU në stomatologji
- SHPU në laborator
- SHPU në kardiologji
- SHPU në lëndët paraklinike
- SHPU në diagnozën me imazhe

Pranë rektoratit të Universitetit të Tiranës, në bashkëpunim me universitetet e Elbasanit dhe të Shkodrës.

- SHPU në studimet Europiane

Pranë departamentit të fizikës të Universitetit Politeknik të Tiranës:

- SHPU në fizikë të aplikuar inxhinierike

Pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, si më poshtë:

- SHPU në agronomi, me drejtimet: përmirësimi gjenetik i bimëve, prodhimi i farave dhe i fadanëve, hortikulturë.
- SHPU në ekonomi agrare, me drejtimet: drejtimi i ndërmarrjeve të agrobiznesit, ekonomi dhe politikë agrare, modelim teknik dhe ekonomik i sistemeve të prodhimit
- SHPU veterinari
- SHPU në shkencat pyjore, me drejtimet: qeverisja ekologjike pyjore, teknologjia e drurit

Pranë Akademisë së Edukimit Fizik dhe sporteve “Vojo Kushi”, si më poshtë:

- SHPU në kulturë, fizikë dhe sport, me drejtimet: didakt i edukimit fizik, specialist i atletikës
- SHPU në mjekësi sportive (në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Tiranës).

2. Shpenzimet për funksionimin e SHPU-ve, për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002, mbulohen nga tarifat e shkollimit dhe nga të ardhura të tjera të krijuara në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

- 3. SHPU-të, për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002, funksionojnë përgjithësisht me korrespondencë, përveç rasteve kur shkolla e lartë universitare i mbulon shpenzimet pa shtesë të fondeve buxhetore.

4. Tarifat e përgjithshme të shkollimit, në SHPU-të, për vitet akademike 2000-2001 dhe 2001-2002 janë:

- 1000 lekë për kandidatët nga stafi akademik i universiteteve publike;
- 5 000 lekë për kandidatët e sistemit buxhetor;
- 50 000 lekë për kandidatët e tjerë.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton çdo vit kuotat dhe modalitetet konkrete për hapjen dhe funksionimin e SHPU-ve dhe kontrollon realizimet buxhetore sipas kritereve të hartuara prej saj.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

## V E N D I M
## Nr.590, datë 2.11.2000

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.222, DATË 24.5.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME KONCESION, TË FORMËS "BOT", PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.222. datë 24.5.1997, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1 shtohet pika 1/a, me këtë përmbajtje:

"Miratohet aneksmarrëveshja, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Shoqërisë B.E.G, s.p.a, Itali, për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit, me koncesion, të formës BOT.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

ANEKS MARRËVESHJE PËR DISA NDRYSHIME TË MARRËVESHJES ME KONCESION TË FORMËS BOT PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT

1. Në nenin 1 "Përcaktime", të Marrëveshjes së Koncesionit, të ndryshohet emërtimi i dhënë

për “Organin Shtetëror të Autorizuar” dhe të bëhet Ministria Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike.

2. Në nenin 1 “Përcaktime”, të Marrëveshjes së Koncesionit, të shtohet termi “Shoqëri e kontrolluar”, që është çdo shoqëri që kontrollohet nga Koncesionari, sipas përcaktimeve të bëra në bazë të nenit 219 të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”.

3. Në nenin 13 të Marrëveshjes së Koncesionit të shtohet “Objekti i këtij Koncesioni mund të realizohet, menaxhohet dhe mirëmbahet nga Koncesionari ose nga një shoqëri e kontrolluar prej tij. Në këtë kuptim në qoftë se Koncesionari vepron nëpërmjet një shoqërie koncesionare të kontrolluar prej tij, Koncesionari mbetet përgjegjës ndaj Organit Shtetëror të Autorizuar për të gjithë detyrimet që përmbahen në Marrëveshjen e Koncesionit”.

4. Në nenin 34 të Marrëveshjes së Koncesionit të hiqet paragrafi “Një aprovim i tillë të përcaktohet brenda 60 ditëve prej nënshkrimit të Marrëveshjes aktuale të Koncesionit”.

## V E N D I M
## Nr.596, datë 13.11.2000

### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2, të seksionit I, në vendimin nr.194, datë 22.5.1999, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:

“- Paga e grupit II “2”Me shkollë të mesme pedagogjike;

Me shkollë të mesme profesionale, ku fitohet specialiteti për mësuesi;

Diplomë mbi shkollën e mesme.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2000, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

## V E N D I M
## NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fehmi Abdiu, | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Sabri Rrapi, | Anëtar i““ |
| Zija Vuci, | Anëtar i““ |
| Hajredin Fuga, | Anëtar i““ |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i““ |
| Kujtim Puto, | Anëtar i““ |
| Sokol Sadushi, | Anëtar i““ |

Kristofor Peçi, Anëtar i“ “

me sekretare Drita Panda e Arbenka Lalica, më datat 18.9.2000 dhe 17.10.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.54 Akti që i përket:

**KËRKUESE:** GJYKATA E RRETHIT TIRANË
**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**
1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë
2.KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë
3.ADMINISTRATORËT E SHOQËRISË “M.LEKA”, përfaqësuar nga juristi Petrit Gaçe, me autorizim
4. FERID TAHJA, LULËZIM SHALA, SHPËTIM STERMASI, YLÇEZAR TORA, përfaqësuar mga avokat Spartak Ngjela.

O B J E K T I:

Papajtueshmëria me Kushtetutën (me nenet 7, 11/1,3, dhe 41/3) të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999 “Për kthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga ana e personave fizikë e juridikë, nga shitja e pasurisë apo transaksioneve të pronësisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e subjekteve të interesuara, avokatin Spartak Ngjela, që kërkoi deklarimin e ligjit të papajtueshëm me Kushtetutën, përfaqësuesin e administratorëve që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Gjykata e Rrethit Tiranë, më datë 30.6.2000, ka marrë në shqyrtim çështjen civile me palë: paditës, Shoqëria “M.Leka”, në administrim dhe të paditur, Ferid Tahja, Lulëzim Shala, Shpëtim Stërmasi e Ylçezar Tora, me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik të shitblerjes. Pala paditëse, kërkesën për pavlefshmëri të shitjes e bazon në ligjin nr.8472. datë 08.04.1999 dhe nenin 92 të Kodit Civil, duke pretenduar se çmimi real i objektit të shitur nuk është 1 600 000 dollarë por 70 000 000 lekë. Gjykata e rrethit arsyeton në vendim se gjatë gjykimit, të paditurit dhe avokati i tyre paraqitën kërkesë me shkrim për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit nr.8472, datë 08.04.1999, pasi ai bie ndesh me nenet 7,11/3 dhe 41/3 të Kushtetutës. Më konkretisht, sipas tyre, ky ligj cënon parimin kushtetues të lirisë ekonomike, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor si dhe parimet juridiko-civile në tërësi.

Gjykata Kushtetuese, pasi i shqyrtoi në tërësi shkaqet e parashtruara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pretendimet e subjekteve të interesuara të bëra në seancë dhe meqenëse gjatë votimit votat u ndanë në mënyrë të tillë që asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar dhe ekziston pamundësi objektive për të riçelur seancën, është e detyruar në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të vendosë refuzimin e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31/a dhe 132 të Kushtetutës si dhe nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 17.11.2000
Nr.54 i Regj.Themeltar.
Nr.81 i Vendimit

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.


U dorëzua për shtyp më 15.11.2000
Doli nga shtypi më 15.11.2000

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3700 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë